



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 24722 prot.

Shkodër, më 02.12. 2025

VENDIM

Nr. 77, datë 27.11.2025

**PËR STREHIMIN EMERGJENT TË FAMILJES SELJA DHE FAMILJES GOMILA NË
NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA (ISH-KONVIKTI I
SHKOLLËS VETERINARE)**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; pikës 19 të VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 24, datë 10.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës ‘Veterinare’ dhe të ‘Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër’”; vërtetimit “Për rënie zjarri”, datë 12.11.2025, të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit; kërkesës së z. L.S., nr. 9016, datë 25.11.2025; kërkesës nr. 23366 prot., datë 12.11.2025, të z. T.G.; procesverbalit të strukturës përgjegjëse të strehimit; si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin emergjent të familjes së z. L.S. dhe të familjes së z. T.G. në njësitë e banimit pranë banesave sociale me qira (ish-konvikti i Shkollës “Veterinare”).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 31 vota

Vota Pro 31

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.12.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al